



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 426/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sadik Deliqit kryetar i subjektit politik URA me seli në Mitrovicë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL A.nr 426/2017 e datës 23.10.2017, e parashtruar nga Sadik Deliqi kryetar i subjektit politik URA me seli në Mitrovicë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Sadik Deliq kryetar i subjektit politik URA me seli në Mitrovicë, në të cilën pretendon se ka pasur parregullsi gjate votimit të numrave për kandidat për kuvend komunal të komunave Mitrovica e Jugut dhe Veriut. Parashtruesi i ankesës kërkon që të rinumërohen dhe të kontrollohen fletëvotimet për vendvotimet 3802B/01R/02/0304

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë për vendvotimet 3802B/01R/02/03/04 në Mitrovica e Jugut dhe e Veriut për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit.

Hudhja e ankesës së ankuesit Sadik Deliq, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr. 426/2017 më datën 24.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.